



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 46  
Podujevë,  
16.03.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik (MPMS), UA. nr. 26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore (MASHT), UA. nr. 34/2014 Funkcionalizimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla (MASHT), Drejtoria për Arsimit shpallë:

### K O N K U R S

#### PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

**Pozita:** Psikolog shkolle

**Vendi:** SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova"

**Lloji i vendit të punës:** me afat të caktuar, deri më 31.08.2018, me orar të plotë

**Numri i pozitave:** një (1) ekzekutues

#### Detyrat kryesore të punës :

- Psikologu i shkollës kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënësve dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional dhe personal të nxënësve;
- Ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Vlerëson dhe interpreton çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësve dhe zhvillimin kognitiv, social, personal dhe emocional të nxënësve;
- Asiston dhe ofron ndihmë në identifikimin nxënësve me vështirësi në të nxënësve, nxënësve të talentuar, identifikon dhe vlerëson nevojat e nxënësve, bashkëpunon me profesionistë tjerë dhe zbaton vlerësime të përshtatshme (të besueshme dhe valide), zhvillon intervista me nxënës, mësues, prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme me qëllim të vlerësimit objektiv, propozon dhe zbaton masa për intervenime psikoedukative individuale dhe në grup.

- Punon drejtpërdrejtë me nxënës, këshillon nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, i këshillon në zgjedhjen e profesionit dhe për tejkalimin e problemeve personale;
- Bashkëpunon me mësimdhënës, prindër dhe komunitet;
- Bashkëpunon me institucionet profesionale; me organet profesionale të shkollës, bashkëpunon edhe me institucione tjera sociale, shëndetësore, organizata joqeveritare, të cilat i kontribuojnë mirëqenies së nxënësve dhe personelit shkollor dhe ndihmojnë në realizimin e qëllimit dhe detyrave profesionale.
- Kryen edhe detyra tjera profesionale të caktuara nga drejtori i institucionit dhe punëdhënësi.

#### **I. KUSHTET:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer Fakulteti Filozofik, Dega e Psikologjisë - Drejtimi Psikologji Shkollore dhe Këshillim,
- Të kenë së paku 3 (tre) vite përvojë pune në profesion,
- Të kenë certifikë të trajnimeve të akredituara, për ofrimin e shërbimeve dhe trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta,
- Të kenë njohuri të punës me kompjuter (Microsoft Office).

#### **II. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra e komunës nr. 14),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar),
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Dëshmi që nuk jeni i ndjekur penalisht,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidati i cili pranohet në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
  - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
  - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
  - Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit,
  - Intervista me kandidatë për psikolog shkolle mbahet në zyrën 33, në objektin e komunës së Podujevës, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen,
- Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, gjegjësisht deri më datën 31.03.2018.

**Agim Blakçori,**  
**u.d. i drejtorit të DKA-së**

